



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10.09.2024

Nr: 176

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. KRESHNIK FASLLI MYRTOLLARI, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 10.09.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Faslli Myrtollari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë", në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Palë të interesuara: Z. Kreshnik Faslli Myrtollari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 90 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data:10.09.2024 Nr: 176
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Faslli Myrtollari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë"

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Z. Kreshnik Faslli Myrtollari, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 24.3.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik TR-PAA-1317. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kreshnik Faslli Myrtollari, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Kreshnik Faslli Myrtollari, rezulton se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Kreshnik Faslli Myrtollari, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II.

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Kreshnik Faslli Myrtollari, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga ndonjë autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar
“Është proceduar në gjykatën themelore në Prishtinë, Kosovë me arsyet si administrator kompanie në vitin 2020 dhe rezulton në gjykim”.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve me shkresën nr. 4999 prot., datë 11.5.2023, vendosi t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklaramëve të bëra.

Me shkresën nr. 777/40 prot.extra 23, datë 16.08.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin "Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Kreshnik Faslli Myrtollari, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja "ç", Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Kreshnik Faslli Myrtollari, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile apo ketë përdorur gjeneralitete të tjera përveç atyre të vetëdeklaruaras;
- Nuk rezulton të jetë dënuar me vendim gjyqësor nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjydhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë nën hetim nga Prokuroria Speciale në Prishtinë, Kosovë, në kuadër të lëndës PS nr. 1/2021, date 11.01.2021, për tri (3) veprat penale "Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", parashikuar nga neni 300 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, "Kontrabandë me mallra", parashikuar nga neni 317 paragrafi 2 të KPRK-se si dhe "Shmangie nga detyrimet" dhe "Shmangie nga tatimet", parashikuar nga neni 313 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe për të njëjtat procesi gjyqësor është duke u zhvilluar. Kjo, është dërguar për gjykim në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ku dhe është duke u shlytur ende.
- Nuk rezulton të jetë ndaluar ose arrestuar në flagrancë nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton t'i jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese sigurisë personale ndaj tij;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton të jete marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Kreshnik Faslli Myrtollari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga "Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk e ka marrë mandatin si anëtar në këshill. Subjekti zgjedhor "Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë", referuar nenit 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në

Këshillin e Bashkisë Tiranë. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumëmbrore të “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, nuk do të mund të përfitojë mandat në këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfituar mandat në këshill, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neni 90 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 90 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

V E N D O S:

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Fasli Myrtollari.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI